

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7071  
E premte, 15 dhjetor 2023  
Çmimi 0.50 €

## Osmani: Serbia po planifikon sulme të reja

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

GJYKATA SPECIALE LIRON NGA BURGJU ISH-NËNKRYETARIN E ORGANIZATËS SË VETERANËVE TË LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, NASIM HARADINAJ

FAQE 4-5

# NASIM HARADINAJ KTHEHET NË KOSOVË

Dhomat e Specializuara në Hagë kanë modifikuar dënimin ndaj ish-nënkryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK), Nasim Haradinaj. Modifikimi i ka mundur Haradinajt lirin nga burgu të enjten, me disa kushte, kanë njoftuar Dhomat e Specializuara në Hagë. Nasim Haradinaj me t'u kthyer nga Haga ka bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve në Glogjan, duke i nderuar bashkëluftëtarët Cen Aliçkaj e Agron Haradinaj, në varrimet e të cilëve kishte munguar pasi ndodhej në paraburgim



## OPINION

MARRËVESHJA QË NUK PO "NËNSHKRUHET", POR PO ZBATOHET ME DINAMIKË TË SHPEJTUAR F.9

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



## AKTUALE



O'BRIEN: SHBA-JA PRET QË QEVERIA E RE NË BEOGRAD T'I PËRMBAHET MARRËVESHJES ME KOSOVËN F.3

ZJARRFIKËSIT PROTESTOJNË SËRISH PARA QEVERISË, TË PAKËNAQUR ME KUSHTET E PUNËS F.7

PESË VJET NGA TRANSFORMIMI I FSK-SË NË USHTRI PROFESIONALE F.5

## EKONOMI



GUVERNATORI I BQK-SË: KLIENTËT E SEKTORIT TË BUJQËSISË TË KENË KUSHTE MË TË FAVORSHME PËRMES FINANCIIMIT NGA BANKAT F.8

KOSOVA DO TË BËHET PJESË E PROGRAMIT EVROPA DIGJITALE NË VLERË PREJ 7 MILIARDË EUROSH F.8

## MUSTAFA: STATUTI ME TË CILIN ËSHTË PAJTUAR BISLIMI PROMOVON AUTONOMINË POLITIKE DHE TERRITORIALE TË SERBËVE NË KOSOVË

F.3



## APELI UL NË 22 VJET BURGIM DËNIMIN NDAJ SALIH MUSTAFËS

F.5

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
+389 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Në samitin e BE-së mospajtime rreth Ballkanit Perëndimor

**BRUKSEL, 14 DHJETOR** - Një ditë pas samitit të përbashkët BE - Ballkani Perëndimor, liderët e Bashkimit Evropian në takimin e Këshillit Evropian do të diskutojnë edhe për procesin e zgjerimit. Edhe pse vëmendja më e madhe është rreth Ukrainës, do të diskutohen edhe disa dosje nga vendet e Ballkanit Perëndimor, porse për to ka disa mospajtime në mes të vendeve anëtare.

Shumica e vendeve të BE-së duan që Këshilli Evropian ta shprehë gatishmërinë për t'i nisur negociatat e anëtarësimit edhe me Bosnjë-Hercegovinën, por ka vende që e kundërshtojnë një gjë të tillë. Nuk ka pajtim as për hapjen e grupit të parë të kapitujve në negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë. Për Maqedoninë e Veriut përsëri kushtëzohet hapja e kapitujve të parë. Për të gjitha këto mospajtime, kanë paralajmëruar në BE, do të diskutohet gjatë samitit që zhvillohet të enjten dhe të premten në Bruksel.



Në tekstin e draftit të konkluzioneve të përgatitura për t'u miratuar në këtë samit do të konfirmohen edhe konkluzionet nga Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme. Sipas draftit, do të përsëritet se "BE-ja rikonfirmon përkushtimin e plotë dhe të rezervë për perspektivën e anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor. Këshilli Evropian

bën thirrje për përshtetimin e këtij procesi". Do të përsëritet, po ashtu, se Këshilli Evropian mbështet edhe planin për rritje ekonomike në Ballkanin Perëndimor si dhe integrimin gradual në mes të BE-së dhe rajonit gjatë procesit të zgjerimit. Sa iu përket vendeve veç e veç të rajonit, në versionin e tashëm të

draftit të konkluzioneve përmenden vetëm Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut. "Këshilli Evropian është i gatshëm t'i nisë negociatat e anëtarësimit në BE me Bosnjë-Hercegovinën, kur të arrihet niveli i nevojshëm i përputhjes me kriteret e anëtarësimit", është versioni i cili tash është në tekstin për këtë shtet. Austria dhe disa shtete kanë kërkuar që gjuha për Bosnjë-Hercegovinën të jetë më pozitive.

Sa i përket Maqedonisë së veriut, sipas dokumentit, "BE-ja është e gatshme ta kompletojë fazën e hapjes së negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut sapo ajo t'i përmbushë obligimet për t'i kompletuar ndryshimet kushtetuese siç është thënë në konkluzionet e Këshillit më 18 korrik 2022 në përputhje me procedurat e brendshme".

"Këshilli Evropian fton Maqedoninë e Veriut ta përshpejtojë kompletimin e këtyre ndryshimeve", thuhet në draft.

Burimet e BE-së thonë se i tërë dokumenti i konkluzioneve do të varet nga arritja e konsensusit për Ukrainën dhe Moldavinë. Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, ka paralajmëruar se nuk do ta pranojë vendimin për nisjen e negociatave me Ukrainën. Por, 26 vendet e tjera të BE-së insistojnë në miratimin e një vendimi të tillë. Ndërkohë, Parlamenti Evropian ka miratuar një raport, nëpërmjet të cilit bën ftesë që të vendoset për nisjen e negociatave edhe me Ukrainën, me Moldavinë dhe me Bosnjë-Hercegovinën. Po ashtu, raporti i PE-së kërkon që BE-ja t'i heqë masat ndaj Kosovës.

Parlamenti Evropian shpreh shqetësim edhe për sjelljen e Hungarisë, e cila, sipas PE-së, po e pengon procesin e zgjerimit, po ashtu edhe për ndryshimin e politikës së Hungarisë ndaj Kosovës. Tjetër shqetësim i Parlamentit është fakti se Hungaria nga 1 korriku i vitit 2024 do ta ketë kryesimin e radhës të BE-së.

## Shqipëri: Deputetët e përjashtuar përplasen me Gardën, shumica miraton rregullore të re

**TIRANË, 14 DHJETOR** - Kuvendi i Shqipërisë ka mbajtur të enjten një seancë, mes tensionesh të ngritura e përplasjesh fizike të deputetëve të grupimit "Rithemelimi", pjesë e opozitës në Shqipëri, me pjesëtarët e Gardës së Republikës që në hyrje të Kuvendit.

Shkak për përplasje fizike u bë tentimi i 13 deputetëve të përjashtuar të këtij grupimi për të hyrë me forcë, duke deklaruar se nuk e njohin vendimin e Komisionit të Etikës të Kuvendit të Shqipërisë.

Komisioni i ka përjashtuar 13 deputetë: Gazment Bardhin, Sali Berishën, Flamur Nokën, Edi Palokën, Albana Vokshin, Elda Hotin, Ervin Salianjin, Bledion Nallbatin, Asllan Dogjanin, Lefter Gëshenjën, Isuf Çelajn, Luan Baçin dhe Xhelal Mziun për shkak të kaosit që kanë krijuar në seancat e mëparshme. Ata kanë ndezur flakadanë dhe janë përplasur apo kanë qëlluar me mjete të ndryshme drejt punonjësve të Gardës dhe ministrave të kabinetit qeveritar. Garda nuk i lejoi të futen në seancë dhe kjo shkaktoi përplasje, me ç'rast u thyen edhe xhamat e derës kryesore të Kuvendit.

Deputetët e përjashtuar u

përpoqën të hynin përmes derës dytësore, por nuk arritën, ndërsa nuk munguan debatet me deputetë të shumicës, që kërkonin të hynin për të marrë pjesë në seancë.

Ndërkaq, deputetë të tjerë të opozitës, ndaj të cilëve nuk kishte masë ndëshkuese, iu nënshtruan një kontrolli të rreptë nga punonjësit e Gardës, për të mos lejuar futjen e gjësedeve të paligjshme, si flakadanë, sprej apo mjete të tjera piroteknike siç ka ndodhur në seancat e kaluara.

Megjithatë, disa prej tyre ia dolën të fusin në sallë flakadanë që i ndezën sapo nisi seanca. Punimet për seancën e Kuvendit nisën mes zhurmës së një pjese të deputetëve të opozitës, që godisnin tavolinat, duke bërë thirrje për anulim të seancës. Kryetarja e Kuvendit, Lindita Nikolla, njoftoi tërheqjen nga rendi i ditës të marrëveshjes për migracionin që ishte nënshkruar në mes të Shqipërisë dhe Italisë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e saj deri në vendimin përfundimtar. I pyetur për vendimin e Gjykatës Kushtetuese për pezullimin e ratifikimit të marrëveshjes me Italinë, kreu i grupit të Partisë Socialiste, Bledi Çuçi, tha se



vendimi u respektua duke e hequr nga rendi i ditës, por tha se nuk do të ketë tërheqje. "Absolutisht jo [nuk tërhiqemi]! Ne do të vazhdojmë t'i qëndrojmë. Unë besoj se kjo është një marrëveshje shumë e rëndësishme për të treguar që jemi vend evropian", tha Çuçi. Brenda Kuvendit pjesëtarë të Gardës ishin pozicionuar jo vetëm para ulëseve të ministrave, siç ndodh kur ka situata të tensionuara, por edhe në pjesët ndarëse mes

deputetëve të shumicës dhe atyre të pakicës.

Nën tymin e mjeteve të ndezura piroteknike dhe zhurmës së krijuar qëllimshëm nga deputetë të pakicës, kryetarja e Kuvendit hodhi në votim ndryshimet e propozuara nga deputetë të Partisë Socialiste për Rregulloren e Kuvendit.

Me këto ndryshime parashihet ashpërsimi i masave ndëshkuese ndaj deputetëve që shkaktojnë situata të tilla. Maksimumi i ndëshkimit nuk do

të jetë më përjashtim për 10 ditë, por deri në 60 ditë.

Pas seancës, që zgjati vetëm 8 minuta, deputeti Gazmend Bardhi tha se Rregullorja e re e Kuvendit do të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese.

Ndërsa kryetari i grupit të deputetëve të Partisë Socialiste, Bledi Çuçi, tha se ndryshimet në Rregullore janë krejt normale. Çuçi mori shembullin e Italisë, dhe theksoi se në situata të tilla, deputetët atje përjashtohen me 15 seanca plenare.

# O'Brien: ShBA-ja pret që qeveria e re në Beograd t'i përmbahet marrëveshjes me Kosovën

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës presin nga qeveria e ardhshme e Serbisë, e cila do të dalë nga zgjedhjet e 17 dhjetorit, t'i vazhdojë bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën si dhe rrugën drejt integritet evropian, tha ndihmësekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien. "Populli serb do të votojë si të dojë. Ne presim që qeveria t'i përmbahet marrëveshjes që ka bërë në lidhje me Kosovën", tha O'Brien në një intervistë për "Zërin e Amerikës".

Ai tha se në muajt e fundit është shënuar përparim për çështjen e Kosovës, duke shtuar se "disa nga çështjet kryesore kontestuese kanë filluar të zgjidhen, si ajo e targave, doganave...".

Zyrtari amerikan tha se duhet bërë përparim i mëtejshëm dhe vuri në dukje se e ardhmja e Ballkanit qëndron në tregun e përbashkët evropian dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian. "Për t'u bashkuar me të vërtetë në tregun e përbashkët evropian, të dyja palët duhet t'i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre, t'i njohin kufijtë dhe të pajtohen për bashkëpunim. Ne presim që



ata të punojnë përsëri - duke filluar me angazhimet që ata tashmë i kanë bërë", tha O'Brien. Derisa ka folur për vazhdimin e negociatave për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, O'Brien tha se ShBA-ja pret ulje të tensioneve në komunat në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe.

"Është një zonë ku forcat e KFOR-it, NATO-s, janë forcuar. Dhe, misioni evropian, EULEX, gjithashtu ka qenë shumë aktiv kohën e fundit. Prandaj, asnjëra palë nuk ka arsye të shkaktojë tensione atje dhe ajo zonë duhet të qëndrojë e qetë", tha ai. Gjendja në veriun e Kosovës, vend i banuar me shumicë serbe,

vazhdon të jetë e tensionuar prej fillimit të këtij viti, kur serbët lokalë i kundërshtuan kryetarët shqiptarë në katër komunat me shumicë serbe, të cilët dolën nga zgjedhjet e bojkotuar nga serbët në prill.

Më 24 shtator gjendja u përshkallëzua pasi Policia e Kosovës u sulmua nga një grup i

armatosur i serbëve në fshatin Banjskë të Zveçanit, ku mbeti i vrarë polici Afrim Bunjaku. Gjatë përlëshjeve që pasuan u vranë edhe tre sulmues serbë.

Kosova ka fajësuar Serbinë për sulmin, por Beogradi ka mohuar përfshirjen në të.

Kthimi i serbëve në institucionet publike është një nga hapat që O'Brien përmendi për uljen e tensioneve. "Qytetarët serbë të Kosovës që jetojnë në atë rajon duhet të mirëprehen përsëri në institucionet publike dhe kjo do t'i zvogëlojë tensionet. Dhe, pastaj, sinqerisht, të dyja palët kanë një punë të madhe për të bërë, për t'u siguruar që ta vazhdojnë rrugën e normalizimit për të cilën u pajtuan në mars në Ohër. Kështu që ka punë për t'u bërë", tha ai.

O'Brien tha, gjithashtu, se ShBA-ja do të vazhdojë të theksojë se sa i rëndësishëm është "përfundimi i kësaj pune në muajt e ardhshëm". "Ekonomitë e tyre tashmë janë të lidhura me Bashkimin Evropian dhe tani ata duhet të zbatojnë reforma dhe të angazhohen për të qenë pjesë e atij komuniteti. Dhe derisa e bëjnë këtë, unë mendoj se tensionet do të ulen dhe ata do të kenë një marrëdhënie më të madhe", tha O'Brien.

## Osmani: Serbia po planifikon sulme të reja



EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

BRUKSEL, 14 DHJETOR - Duke folur para Samitit të Liderëve të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor, që u mbajt të mërkurën në Bruksel, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha para gazetarëve në Bruksel se "Serbia po planifikon sulme të reja ndaj Kosovës". Osmani para takimit tha se "do t'i

informojë liderët evropianë për informatat që kanë mbledhur organet tona të sigurisë së bashku me partnerët ndërkombëtarë në këtë drejtim". "Këto janë alarme që duhet t'i marrim shumë seriozisht dhe të veprojmë si parandalim në mënyrë që Serbia të mos lejohet më ta destabilizojë rajonin tonë", ka thënë ajo. Sipas saj, situata në botë bën që të gjithë të tregohen të kujdesshëm për sigurinë edhe

në rajon.

Ajo, po ashtu, tha se ka ardhur me kërkesën që menjëherë të hiqen masat ndaj Kosovës, duke i quajtur të padrejta. "Për fat të keq, Serbia ende udhëhiqet nga njerëz të cilët dëshirojnë ta kthejnë rajonin tonë në vitet '90. Ne nuk duhet të lejojmë që një mentalitet i tillë, një logjikë e tillë, të triumfojë. Prandaj ne po punojmë me partnerët tanë evropianë që të rritet siguria në

Kosovë, sidomos aspekti i sigurisë rreth kufirit me Serbinë. E dyta, që të hiqen masat ndaj Kosovës dhe të ketë masa ndaj Serbisë për shkak të agresionit që është kryer më 24 shtator. Për fat të keq, deri më tash nuk ka pasur ndonjë veprim, dhe nëse vazhdohet pa asnjë veprim, atëherë Serbia do ta marrë këtë si një nxitje", ka thënë Osmani duke shtuar se Serbia, sipas saj, po planifikon sulme të reja.

Më 24 shtator një grup i armatosur i serbëve sulmoi Policinë e Kosovës në Banjskë në veri të Kosovës dhe vrau rreshterin Afrim Bunjaku. Më pas, në shkëmbimin e zjarrit, mbetën të vrarë tre sulmues serbë. Përgjegjësinë për sulmin e ka marrë Millan Radoičiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe. Kosova akuzoi Serbinë se qëndron pas sulmit, por Beogradi zyrtar e mohoi.



GJYKATA SPECIALE LIRON NGA BURG U ISH-NËNKRYETARIN E ORGANIZATËS SË VETERANËVE TË LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, NASIM HARADINAJ

# Nasim Haradinaj kthehet në Kosovë

Dhomat e Specializuara në Hagë kanë modifikuar dënimin ndaj ish-nënkryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL-UÇK), Nasim Haradinaj. Modifikimi i ka mundësuar Haradinajt lirim nga burgu të enjten, me disa kushte, kanë njoftuar Dhomat e Specializuara në Hagë. Nasim Haradinaj me t'u kthyer nga Haga ka bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve në Glogjan, duke nderuar bashkëluftëtarët Cen Aliçkaj e Agron Haradinaj, në varrimet e të cilëve kishte munguar pasi ndodhej në paraburgim

se Haradinaj pati mundësi të reflektonte për veprimet e veta gjatë mbajtjes së tij në objektin e paraburgimit të DHSK-së dhe në bazë të raportit ai kishte respektuar rregullat e objektit të paraburgimit gjatë muajve të fundit.

Gjithashtu, kryetarja Trendafilova mori parasysh pendesën e Haradinajt dhe zotimin e tij se nuk

do të përfshihej në veprime të tjera që mund të karakterizoheshin si vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe se do t'i përmbushë të gjithë kushtet e përcaktuara për lirim dhe t'ij.

Trendafilova theksoi se në qoftë se Haradinaj nuk përmbush cilindo prej kushteve të përcaktuara në vendim, atëherë vendimi do të anulohet.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka reaguar pas lirim të Nasim Haradinajt nga Gjykata Speciale.

Haradinaj, i cili ka edhe lidhje familjare me Nasim Haradinaj, e ka mirëpritur lajmin për lirim dhe t'ij. "Mirë se kthehesh në familje, Nasim1", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, në profilin e vet në "Facebook" ka shpërndarë disa fotografi ku Nasim Haradinaj shihet duke bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve në Glogjan. "Nasimi në homazhe te dëshmorët e atdheut në Glogjan. Nga një lule në shenjë nderimi, në veçanti për bashkëluftëtarët Cen Aliçkaj e Agron Haradinaj në varrimet e të cilëve mungoi", ka shkruar Ramosaj.

**EPOKA E RE**

Mal QORRAJ

HAGË, 14 DHJETOR - Nasim Haradinaj është kthyer të enjten në Kosovë pasi kryetarja e Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK), Ekaterina Trendafilova, vendosi ta modifikojë dënimin e Haradinajt për ta liruar nga paraburgimi ku po mbahej në Hagë, sipas kushteve të përcaktuara në vendim. Këto kushte do të jenë në fuqi gjatë pjesës së mbetur të dënimit të dhënë nga Paneli i Gjykatës së Apelit, konkretisht për pjesën e mbetur të dënimit me katër vjet e tre muaj. Për marrjen e vendimit, kryetarja u këshillua me gjykatësit e paneleve që dhanë dënimin sikurse parashihet në nenin 51(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"),

mori parasysh faktorët e rregullës 196(3) të Rregullores së Procedurës dhe Provave si dhe seancën që mbajti me Haradinaj.

Gjithashtu, sikurse u përcaktua në vendimin e saj të mëparshëm të 12 tetorit 2023 lidhur me uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimit të Haradinajt, kryetarja mori parasysh edhe raportin e dorëzuar nga administratorja në lidhje me sjelljen e Haradinajt në objektin e paraburgimit.

Kryetarja Trendafilova mori parasysh se, megjithëse veprat penale për të cilat Haradinaj u dënua janë padyshim të rënda, duke marrë parasysh efektin mjaft negativ të zbulimit të informacionit konfidencial mbi dëshmitarë (të mundshëm), ishin disa faktorë që peshuan në favor të modifikimit të dënimit të tij.

Konkretisht, Trendafilova konstatoi



## Apeli ul në 22 vjet burgim dënimin ndaj Salih Mustafës

HAGË, 14 DHJETOR - Paneli i Apelit në Gjykatën Speciale e ka ulur në 22 vjet burgim dënimin prej 26 vjetësh për ish-komandantin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Salih Mustafa, duke e përfshirë kohën e kaluar në paraburgim.

Mustafa ndodhet në qendrën e paraburgimit në Hagë që prej shtatorit të vitit 2020.

Vendimi për ulje të dënimit është bërë me dije nga kryetarja e trupit të Apelit, Michele Picard, të enjten, në sallën e gjyqit në Hagë, ku i pranishëm ishte edhe Mustafa.

Aktgjykimi i 14 dhjetorit është i pari i Apelit për krime lufte i shqiptuar në Gjykatën Speciale.

“(Paneli i Apelit) Anulon dënimin me 10 vjet burgim në lidhje me pikën 1 të aktakuzës dhe cakton një dënim me 8 vjet burgim; anulon dënimin me 22 vjet burgim në lidhje me pikën 3 të aktakuzës dhe cakton një dënim me 20 vjet burgim; anulon dënimin me 25 vjet burgim në lidhje me pikën 4 të aktakuzës dhe cakton një dënim me 22 vjet burgim. Anulon dënimin e njëzuar me 26 vjet burgim për z. Mustafa dhe cakton një dënim të njëzuar me 22 vjet burgim për zotin Mustafa, duke kaluar kohën e kaluar në paraburgim”, ka thënë kryetarja e Apelit, Michele Picard, duke sqaruar se verdikti për fajësinë e tij për pikat 1, 3 dhe mbetet në fuqi porse vetëm është ulur dënimi.

Salih Mustafa ishte dënuar në dhjetor të vitit të kaluar nga Gjykata Speciale me 26 vjet burgim si dënim të njëzuar për vrasje të paligjshme, ndalim arbitrar dhe torturë. Ai ishte dënuar me 10 vjet burgim për ndalim arbitrar, 22 vjet burgim për torturë dhe 25 vjet burgim për



vrasje të paligjshme.

Mustafa ishte shpallur i pafajshëm për trajtim mizor. Vetë ai ishte deklaruar i pafajshëm për këto krime.

Picard ka thënë se aktgjykimi duhet të zbatohet me efekt të menjëhershëm, ndërkaq ka urdhëruar që Mustafa të mbetet paraburgim deri në finalizimin e masave për dërgim në shtetin ku do ta vuajë dënimin.

Më vonë gjatë këtij viti Salih Mustafa e kishte apeluar vendimin prej 26 vjetësh burgim duke kërkuar shpalljen e një vendimi pafajësie apo ulje të dënimit.

Në anën tjetër, Zyra e Prokurorit të Specializuar kishte kërkuar që aktgjykimi dënues të mbetet në fuqi meqë, sipas saj, për këtë kishte prova të besueshme.

Dënimi ndaj Mustafës kishte shënuar aktvendimin e parë të Speciales lidhur me hetimet për

krime lufte në Kosovë.

Pasi Salih Mustafa argumentoi se dënimi ndaj tij është i tepruar, Paneli i Apelit ka analizuar jurisprudencën ndërkombëtare dhe të Kosovës në lidhje me krime lufte të krahasueshme me ato për të cilat u dënua Mustafa, tha të enjten kryetarja e trupit të Apelit, Michele Picard. “Paneli i Apelit konstaton se në çështjet e gjykuara nga Tribunali Ndërkombëtar dhe nga gjykatat e Kosovës, lidhur me krime lufte të krahasueshme me ato për të cilat u dënua z. Mustafa, dënimet e dhëna ishin më të shkurtra se dënimi i z. Mustafa”, tha ajo.

Ajo bëri me dije se “paneli konstatoi se mospërputhja midis dënimit të zotit Mustafa dhe dënimeve që analizoi paneli, tregon se trupi gjyqësor i tejkaloi kufijtë e diskrecionit në këtë rast”. “Rrjedhimisht, paneli i Apelit

gjykon se duke i dhënë zotit Mustafa dënime jashtë proporcionit të arsyeshëm krahasuar me një varg dënimesh të dhëna në rrethana të ngjashme për vepra penale të ngjashme, trupi gjyqësor ka kryer një gabim të dallueshëm në dënimin e dhënë”, tha Picard para se ta shqiptonte vendimin, me të cilin Mustafës iu hoqën 4 vjet burgim.

Mustafa kishte parashtruar disa kundërshtime duke pretenduar se janë bërë gabime juridike dhe faktike në vendimin e trupit gjyqësor për ta shpallur atë fajtor, por ato u rrëzuan nga Paneli i Apelit.

Përmes avokatit të tij, Mustafa kishte thënë se gjatë shqiptimit të dënimit trupi gjyqësor ishte selektiv dhe mori parasysh vetëm dëshmitarët që dëshmuuan kundër Mustafës. Këto kundërshtime u rrëzuan nga Paneli i Apelit.

Mustafa ishte arrestuar dhe transferuar në njësinë e paraburgimit të Gjykatës Speciale më 24 shtator të vitit 2020.

Krimet, për të cilat ai mbahet përgjegjës, është thënë se janë kryer në kompleksin e ndalimit në Zllash në Kosovë në prill të vitit 1999.

Procesi gjyqësor ndaj tij kishte nisur më 15 shtator të vitit 2021 dhe gjatë tij kanë dëshmuar 29 dëshmitarë, 14 prej tyre të Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe 15 të mbrojtjes.

Në mesin e këtyre dëshmitarëve kishte edhe persona që u paraqitën si viktima.

Në muajin prill Gjykata Speciale e Kosovës kishte nxjerrë një vendim, me të cilin e detyron Mustafën t’ua paguajë 207 mijë euro viktimave të vrasjes së paligjshme, ndalimit arbitrar dhe torturës.

Në shpalljen e urdhrin për zhëmtim më 6 prill 2023, gjykata konstatoi se janë tetë viktima të cilave do t’u takojë dëmshpërblimi.

Sipas Prokurorisë së Specializuar në Hagë, në rastin e Mustafës të gjitha viktimat janë shqiptarë të Kosovës.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, që ndryshe njihen edhe si Gjykata Speciale - hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

Gjykata Speciale e Kosovës është formuar pas publikimit të një raporti të Këshillit të Evropës më 2011, nën autorësinë e senatorit zviceran Dick Marty. Në vitin 2015 deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar për formimin e kësaj gjykate. (REL)

## Pesë vjet nga transformimi i FSK-së në ushtri profesionale

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Të enjten është shënuar pesëvjetori i transformimit ligjor të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) nga forcë me kapacitete të kufizuara në ushtri profesionale

Në këtë përvjetor, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka theksuar se ky ndryshim është arritur falë punës së jashtëzakonshme të ushtarëve, oficerëve dhe stafit civil përmes një angazhimi të palodhshëm e të pandërprerë, frymëzuar nga amaneti i dëshmorëve dhe vullneti i hekurt për të ardhmen e brezave të rinj, por sigurisë dhe bashkëpunimit të ngushtë me shtetet anëtare të NATO-s, aleatët tanë strategjikë, në veçanti Shtetet e Bashkuara të Amerikës. “Partnerë këta kyçë me të cilët do të vazhdojmë të punojmë me synim rritjen e bashkëpunimit dhe realizimin e objektivave tona të përbashkëta”, u shpreh ministri Maqedonci.

Më tej ai theksoi se “do ta vazhdojmë tranzicionin e FSK-së në ushtri me kapacitete të plota, e gatshme për ta përmbushur misionin e saj vital të garantimit të sigurisë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe mbrojtjen e integritetit të territorit të saj, me synim ruajtjen e paqes, stabilitetit dhe ofrimin e kontributit përtej kufirit gjeografik të shtetit tonë, integrimin në strukturat euroatlantike si aleat me peshë i partnerëve tanë duke kaluar nga konsumues të sigurisë në ofrues të saj”.

Më 14 dhjetor të vitit 2018 Kuvendi i Kosovës miratoi tri ligjet që e ndryshuan mandatin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri të Kosovës.

Ligjet që u miratuan ishin: Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.



## Reka: Pa demilitarizimin e plotë të Serbisë nuk ka paqe në Ballkan

NJU-JORK, 14 DHJETOR - Shefi i Misionit në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju-Jork, ambasadori Blerim Reka, ishte folës në Foreign Policy Association of CP me temën "Kosova dhe Ballkani Perëndimor". Reka në praninë e rreth 100 ish-diplomatëve, ushtarakëve e ekspertëve gjeopolitikë amerikanë ka folur për qasjen e gabuar ndërkombëtare të

tolerimit të Serbisë për ta tërhequr drejt Perëndimit. "Strategjia e tillë Serbia-centriste prodhoi efektin e kundërt: Serbia kurrë më shumë nuk ka qenë në Lindje, e Rusia, Kina dhe Irani kurrë më shumë brenda Serbisë. Mungon vetëm edhe Koreja e Veriut që Beogradi të kompletojë të qenit pjesë e regjimeve autoritare lindore", ka theksuar ambasadori Reka. Ai ka theksuar se agresioni i

fundit i Serbisë kundër Kosovës, me kërcënimet edhe kundër Bosnjë-Hercegovinës dhe Malit të Zi, vetëm vërtetojnë se pa demilitarizimin e plotë të Serbisë nuk ka paqe në Ballkan. "Serbia nuk ka ndryshuar, por është e njëjta: si ajo monarkiste, si komunistja, si 'post-komunistja'. Gjithmonë hegjemoniste", ka pohuar Reka.



## Mustafa: Statuti me të cilin është pajtuar Bislimi promovon autonominë politike dhe territoriale të serbëve në Kosovë

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Ish-kryeministri Isa Mustafa ka reaguar ndaj deklaratës së zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi dhënë në RTK, në të cilin televizion ka thënë se në gusht të vitit 2015 Mustafa kishte nënshkruar për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe me "22 kompetenca ekzekutive". "Besnik Bislimi në një intervistë mbrëmë në RTK bëri fushatë të ulët politike. Opozitën e quajti bashkëpunëtore të Serbisë dhe, për ta larë veten dhe qeverinë Kurti nga përgjegjësitë për marrëveshjen e fundit me Serbinë, u mor edhe me mua. Nuk

ndiej ndonjë kënaqësi kur njerëzit që nuk i konsideroj merren me mua, sepse si kundërshtar politik do të duhej të merreshin me opozitën, pasi unë nuk po shfaq pretendime t'ua marr pushtetin. Por dëshiroj të theksoj se çdo gjë që e tha mbrëmë në kontekst të dokumentit të vitit 2015 ishte një pavërtetë e kulluar, për fat të keq, e dalë nga goja e një zëvendëskryeministri të Republikës së Kosovës dhe profesor i Kolegjit Amerikan në Prishtinë", ka reaguar Mustafa në "Facebook".

Ai ka thënë se statuti i Asociacionit që qarkullon në opinion dhe të



cilin tani e kanë edhe deputetët nuk konsiston në asnjë formë me marrëveshjen e vitit 2013. "Vetëm thirrjet në mënyrë abuzive në të.

Statuti, me të cilin është pajtuar z. Bislimi, promovon autonominë politike dhe territoriale të serbëve në Kosovë. Prandaj edhe nuk

mund të jetë Statut i Asociacionit, por është Statut mbi Autonominë? Është diçka krejtësisht e re, që nuk mund të mbështillet me marrëveshjet e mëparshme. Janë të çoroditura edhe pikëpamjet e Bislimit mbi mënyrën sesi do t'i përcillet ky statut në shqyrtim Gjykatës Kushtetuese, sepse ajo nuk është mentore e qeverisë dhe recesente e vendimeve të saj, por ajo shqyrton se a është një akt juridik i qeverisë në harmoni me Kushtetutën; jo një akt i hartuar nga jashtë qeverisë. Në këtë rast qeveria nuk mund ta luajë rolin e postieres, por të vendimmarrëses", ka thënë Mustafa.

## KEDS-i po dyfishon kapacitetet e rrjetit për qindra biznese të Prishtinës

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Qindra biznese të Prishtinës, të alokuara në magjistralen Prishtinë - Ferizaj, nga fillimi i Veternikut e tutje do të kenë rrjet elektrik komplet të ri të tensionit të mesëm, pasi në Zonën Industriale të kryeqytetit, ku kanë selitë edhe disa nga bizneset më të mëdha në vend, KEDS-i po bën investim të fuqishëm, rrjedhimisht po dyfishon kapacitetet e rrjetit të shpërndarjes.

Ky investim gjigant parashihet të ketë impakt në ekonominë e vendit, pasi biznese të shumta të



shtrira në atë pjesë do të kenë shërbime dukshëm më kualitative dhe më të sigurt. Për mbarëvajtjen e punimeve

aty është përkujdesur edhe kryeshefi ekzekutiv i KEDS-it, Alpin Dogan, me ekipin e tij, i cili ka vizituar punimet që po

zhvillohen aty. "Ne si kompani gjithmonë kemi qenë në mbështetje të ekonomisë së Kosovës. Ky investim është tregues se ne po bëjmë më të mirën që bizneset të kenë afarizëm sa më të lehtë, sa më të mirë dhe sa më të sigurt", ka theksuar Dogan.

Aty dalja numër 5, që fillon nga Nënstacioni Prishtina 7 dhe shkon në drejtim të Ferizajt, po shndërrohet nga 10 kV në 20 kV, në tërë gjatësinë e saj përshkon mbi 10 kilometra. Bashkë me të po zëvendësohen edhe 12 transformatorë, nga të cilët 4

janë trafostacione të reja. E tërë linja është nëntokësore dhe punimet tashmë janë në fazën përfundimtare.

KEDS-i që nga fillimi i operimeve, në vazhdimësi ka investuar, pos në mijëra projekte për konsumatorët shtëpiakë, edhe në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes në zonat ku janë të alokuara bizneset.

Rrjeti i trashëguar ishte në gjendje të rënduar, por tashmë falë investimeve të shumta po merr pamje krejtësisht tjetër. Nga këto investime edhe bizneset frymojnë më lirshëm.

## "Ibër Lepenc"-i dhe Fakulteti i Ndërtimtarisë arrijnë marrëveshje bashkëpunimi



PRISHTINË, 14 DHJETOR - Kryeshefi ekzekutiv i ndërmarrjes "Ibër Lepenc", Faruk Mujka, ka bërë me dije se, bazuar në interesat e përbashkëta, është arritur një marrëveshje në mes të këtyre dy institucioneve me qëllim të avancimit dhe ngritjes së arritjeve profesionale në arsimin e lartë, shkencë, bashkëpunimin arsimor dhe akademik ndërmjet dy institucioneve, duke hapur mundësi të reja bashkëpunimi

për studentët, stafin akademik dhe atij administrativ. "NPH 'Ibër - Lepenc' dhe Fakulteti i Ndërtimtarisë do të bashkëpunojnë me qëllim të zhvillimit profesional të studentëve, aktiviteteve të përbashkëta për realizimin e nevojave ndërinstitucionale, projekte të përbashkëta në lëmenjtë e ujit, konstruksioneve ndërtimore, gjeodezisë dhe mjedisit. Fakulteti do të nxjerrë vendim për angazhimin e studentëve

dhe profesorëve, të cilët do të rekrutohen në zyrat e ndërmarrjes për realizimin e punës së praktikës profesionale si dhe në raste kur nevojiten studime të caktuara në fushën e inxhinierisë ndërtimore", ka thënë Mujka. Marrëveshja është nënshkrua nga kryeshefi i NPH "Ibër Lepenc" Sh. A., Faruk Mujka dhe dekani i Fakultetit të Ndërtimtarisë, Florim Grajçevci.

## Zjarrfikësit protestojnë sërish para qeverisë, të pakënaqur me kushtet e punës

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Për herë të dytë zjarrfikësit e Kosovës kanë protestuar para objektit të qeverisë. Kjo protestë është mbajtur të enjten për shkak të mospërmbushjes së kërkesave të tyre rreth moskompensimit për rrezikshmëri në punë.

Muharrem Beka, kryetari i Sindikatës së Zjarrfikësve, ka theksuar se gjendja e tyre është shumë alarmante dhe kjo heshtje e institucioneve vite me radhë ka shkaktuar situatë të pakëndshme. "Zjarrfikësit e Kosovës e kanë riaktivizuar protestën në shenjë të pakënaqësive të krijuara që kemi pranuar nga Qeveria e Kosovës. Gjendja në shërbimin e zjarrfikësve në Kosovë është shumë alarmante dhe kjo heshtje e institucioneve ka shkaktuar këtë situatë të



pakëndshme. Ftojmë qeverinë ta analizojë gjendjen e krijuar ndaj zjarrfikësve dhe të sigurojë mjete që ta përmirësojë gjendjen e krijuar. Kjo neglizhencë është e pakuptimtë. Që nga viti 2008 është kjo gjendje e zjarrfikësve", ka thënë Beka,

duke kërkuar që urgjentisht kjo gjendje të trajtohet nga institucionet. "Përndryshe nuk do të tolerojmë më. Te çështja e rrezikshmërisë zjarrfikësit nuk pajtohen me vendimin e qeverisë. Kemi kërkuar të shtohet numri i zjarrfikësve të



rinj, gjithashtu kemi kërkuar buxhet shtesë për vitin 2024 në mënyrë që të mos i kemi problemet e njëjta. Zjarrfikësit nuk po kërkojnë asgjë pos zbatimit të ligjit, që nënkupton trajtim të dinjitetshëm", ka thënë Beka.

Ai ka paralajmëruar se do t'i vazhdojnë protestat nëse nuk zbatohen kërkesat e tyre. "Edhe një herë po bëjmë thirrje që urgjentisht kjo gjendje të trajtohet", ka thënë Muharrem Beka, kryetar i Sindikatës së Zjarrfikësve.

## Vendoset pllaka shënjuese në 25-vjetorin e sulmit terrorist të Serbisë në lokalit "Panda"

PEJË, 14 DHJETOR - Në 25-vjetorin e rastit "Panda" është vendosur pllaka shënjuese për këtë rast, në lokalit që në tetor të këtij viti Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e ka përfshirë në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme. "Në kulmin e terrorit të Serbisë ndaj shqiptarëve në Kosovë, në hapësirat e këtij lokali, më 14 dhjetor 1998, përmes urdhrave të sigurimit të shtetit të Serbisë, u ekzekutuan gjashtë të rinj serbë. Për këtë rast të inskenuar nga autoritetet serbe u burgosën gjashtë të rinj shqiptarë të pafajshëm, të cilët u maltretuan rëndë nga policia serbe. Ata u shpallën të pafajshëm, por dëmi i shkaktuar nga pasojat e torturave në burgje është i pariparueshëm", shkruhet në pllakë. Me këtë rast, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, së bashku me zëvendësministrat e drejtësisë, Blerim Sallahu dhe



Vigan Qorolli, si dhe drejtorin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës, Atdhe Hetemi, vizituan hapësirat e lokalit "Panda". U theksua se si 25 vjet më parë

nga sulmi terrorist i Serbisë në atë lokal u vranë gjashtë të rinj serbë, të moshave 14, 16, 17, 18 dhe 24 vjeç, në përpjekje për ta justifikuar spastrimin etnik dhe gjenocidin në Kosovë. Më pas, në

Pejë i arrestuan më shumë se 150 shqiptarë. Të rinjtë Agron Kollçaku, Behar Bajri, Beqir Loxha, Gazmend Bajrami, Vllaznim Pergjegaj dhe Xhevdet Bajrami, të moshave nga 17 deri

në 22 vjeç, u burgosën padrejtësisht dhe u torturuan në burgjet serbe.

Në takimin e përbashkët me ish-të burgosurit ata rrëfyan për torturat çnjerëzore në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, ku i kishin mbajtur deri në qershor 1999. Nga aty i kishin dërguar në burg në Leskoc të Serbisë.

Pas shumë maltretimeve të përjetuara në burgje, në nëntor 1999, gjykata në Serbi i shpalli të gjashtë të pafajshëm, në mungesë të provave. Ata u dënuan me nga një vit burg për shkelje të rendit publik. Një muaj më pas, me ndërmjetësimin e organizatave ndërkombëtare, pesë nga ta u liruan, ndërsa Behar Bajri u mbajt në burg deri më 6 dhjetor 2000.

U theksua përgjegjësia e shtetit të Serbisë për të vërtetën për këtë rast, dhe të gjitha krimet e kryera ndaj shqiptarëve gjatë luftës 1998-99.

## Mbahet takimi i prokurorëve që trajtojnë veprat penale kundër dhunës në familje

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Me ftesë të koordinatores për veprat penale kundër dhunës në familje nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Sevdije Morina, është mbajtur takim në mes të prokurorëve që trajtojnë këto vepra penale nga të gjitha prokuroritë themelore të Republikës së Kosovës.

Në këtë takim u diskutua për problemet dhe sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen prokurorët e shtetit në trajtimin e rasteve që kanë të

bëjnë me veprat penale kundër dhunës në familje. Ndër të tjera, u diskutua edhe për Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, i cili ka për qëllim ta parandalojë dhe trajtojë dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore, të mbrojtje dhe të kontribuojë në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave si dhe t'i ndërtojë mekanizmat e

nevojshëm për ofrimin e mbështetjes ndaj viktimave të të gjitha formave të dhunës të rregulluara me këtë ligj. Në këtë takim, ku të pranishëm ishin edhe përfaqësues nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, të gjithë prokurorët koordinatorë u zotuan që do të vazhdojnë me përkushtim edhe më të madh, me urgjencë dhe me efikasitet, t'i trajtojnë të gjitha rastet që ndërliken me veprat penale kundër dhunës në familje.



## Bregu: Tregu i përbashkët rajonal plotësisht funksional, anija jonë drejt destinacionit të tregut unik të BE-së

**BRUKSEL, 14 DHJETOR** - Liderët e Bashkimit Evropian (BE) dhe të Ballkanit Perëndimor (BP) përsëritën në Samitin BE - BP, të organizuar nga Këshilli i BE-së dhe në Bruksel, angazhimin e përbashkët për t'i rritur përpjekjet për ta forcuar integrimin e Ballkanit Perëndimor me Tregun Unik të BE-së, me Tregun e Përbashkët Rajonal të BP-së (CRM), që shërben si një hap themeltar për integrimin e rajonit në BE. "Një vit pas Samitit BE - BP në Tiranë ne ndiejmë edhe më shumë hapat dhe ndjesinë emergjente për reforma dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal nga ana e rajonit, edhe për gatishmërinë institucionale dhe buxhetore të një BE-je të përshtatshme për zgjerim. Thellimi i integritimit tonë ekonomik dhe vazhdimi i ndërtimit të politikave që na bashkojnë më shumë me BE-në është gjithmonë i vlefshëm. Një Treg i Përbashkët Rajonal i vërtetë dhe plotësisht funksional, i papenguar nga mosmarrëveshjet rajonale, mund të jetë anija jonë drejt Tregut



Unik të BE-së, i cili, sipas të gjitha gjasave, do të jetë perspektiva jonë e ardhshme", tha në samit sekretarja e përgjithshme e RCC-së, Majlinda Bregu.

BE-ja e ftoi rajonin, me ndihmën e RCC-së dhe partnerëve, për të përgatitur një pasardhës ambicioz të planit aktual të veprimit CRM përpara se ai aktual të përfundojë më 2024. "Faza e re e Tregut të

Përbashkët Rajonal që RCC filloi të përcaktojë duke pasur parasysh katër liritë e Tregut Unik të BE-së do të përfshijë synime të qarta strategjike në fusha të tilla si arsimit, inovacioni, digjitalizimi, agjenda e gjelbër, energjia, ndotja e ajrit, migrimi, ikja e trurit dhe fuqizimi ekonomik i grave. Zhvillimi i potencialit të rajonit do të kërkojë burime të reja dinamizmi dhe

transformimi për t'i kapërcyer sfidat. Megjithatë, në mënyrë që të kemi plotësisht në funksion motorët e evropianizimit dhe konvergencës, CRM dhe Plani i Rritjes i BE-së i publikuar së fundmi për rajonin, do të duhet të shoqërohen me debatin buxhetor dhe rregullimin e instrumenteve të BE-së si Marrëveshjet e Stabilizim Asocimit", ka pohuar Bregu.

Udhëheqësit BE-BP mirëpritën reduktimin e kostove të roaming-ut midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor që nga 1 tetori 2023, një arritje e lehtësuar nga RCC dhe BE, me synimin për të zhvilluar një marrëveshje afatgjatë roaming për ta përfshirë rajonin në zonën e BE-së 'Roam like at home'. Është shprehur vullneti për vazhdimin e rritjes së sigurisë kibernetike në bashkëpunim me Ballkanin Perëndimor, duke theksuar rëndësinë në rritje të RCC në rolin lehtësues në këtë fushë. "Jemi përpara një pune kolosale, në qendër të së cilës do të jenë reformat e brendshme, integrimi ekonomik dhe bashkëpunimi rajonal si dhe përafrimi me çdo kusht me BE-në", ka theksuar Bregu.

Pjesëmarrësit e Samitit nënvizuan nevojën e angazhimit nga partnerët e Ballkanit Perëndimor për bashkëpunim rajonal gjithëpërfshirës dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, përfshirë edhe me shtetet anëtare të BE-së.

## Guvernatori i BQK-së: Klientët e sektorit të bujqësisë të kenë kushte më të favorshme përmes financimit nga bankat



**PRISHTINË, 14 DHJETOR** - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) së bashku me Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC), Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe institucionet financiare kredidhënëse dhe siguroese, ishte pjesë e projektit "Financimi i bujqësisë dhe sigurimet bujqësore, projektet e IFC-së në Kosovë".

Ky projekt kishte një rëndësi të veçantë për faktin se fermerëve do t'u mundësonte qasje më të lehtë në financa, kushte më të favorshme dhe qëndrueshmëri të investimit

për shkak të reduktimit të rezikut nga produktet e sigurimit bujqësor. "Ky projekt duhet të kishte rëndësi të veçantë edhe për faktin se do të mundësonte që klientët në sektorin e bujqësisë të kenë kushte më të favorshme përmes financimit nga bankat dhe institucionet kredidhënëse, rrisnin konkurrencën, qëndrueshmërinë dhe pavarësinë e zhvillimit pa u bërë barrë e ndihmave shtetërore për mbulimin e humbjeve që lidhen me ngjarjet klimatike sikurse janë ngricat, breshëri, thatësira apo reshjet e tepruara klimatike", është

shprehur guvernatori Ahmet Ismaili në ngjarjen përmbyllëse të projektit.

Guvernatori Ismaili ka shtuar se ekziston potencial i madh për mbështetje nga industria financiare për kreditimin dhe sigurimin e sektorit të bujqësisë në mbështetje financiare, zbutjes së rreziqeve dhe rritjes së qëndrueshmërisë.

Ismaili në fjalimin e tij i ka inkurajuar institucionet financiare për ta mbështetur bujqësinë, derisa ka dhënë rekomandime konkrete për politikëbërjen në këtë drejtim.

## Kosova do të bëhet pjesë e programit Evropa Digjitale në vlerë prej 7 miliardë eurosh

**PRISHTINË, 14 DHJETOR** - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka nënshkruar marrëveshjen kornizë të programit të Evropës Digjitale, ndërsa nga ana e Komisioni Evropian marrëveshja është nënshkruar nga Roberto Viola, komisionar për Komunikim, Rrjete, Përbajtje dhe Teknologji. Marrëveshja Kornizë ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës ia mundëson Kosovës pjesëmarrjen në Programin e Bashkimit Evropian "Evropa Digjitale". Ky program është i ri i krijuar dhe financuar nga Bashkimi Evropian me qëllim që të bëhet i mundur transformimi digjital, rritja e përdorimit të teknologjive digjitale për bizneset dhe qytetarët me çfarë do të ketë impakt pozitiv në

zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Përmes pjesëmarrjes së Kosovës në këtë program do të forcohet dhe zhvillohet më tej bashkëpunimi ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës, po ashtu zbatimi i kësaj marrëveshje do të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës pas miratimit në qeveri dhe Kuvend të Republikës së Kosovës.

Bizneset, administrata publike si dhe OJQ-të nga vendet nënshkruese të kësaj marrëveshje, do të kenë mundësi të aplikojnë në projekte që ndërlidhen me fusha specifike si intelijenca artificiale dhe aftësi të avancuara digjitale.

Ky program ka për qëllim ta rritë qasjen në digjitalizim të qytetarët, bizneset dhe institucionet, dhe



përmes granteve strategjike të avancojë katër fusha: resurset kompjuterike me performancë të lartë, Intelijenca Artificiale (IA), shkathësitë e avancuara digjitale, si

dhe përsheptimi dhe shfrytëzimi më i mirë i kapaciteteve digjitale dhe ndërveprueshmëria (interoperabiliteti). Ky program synon t'i afrojë shtetet e

Ballkanit Perëndimor me ekonominë e shoqërinë e BE-së për ta mbështetur digjitalizimin në përgjithësi, veçanërisht të bizneseve të vogla dhe të mesme.



# Marrëveshja që nuk po “nënshkruhet”, por po zbatohet me dinamikë të shpejtuar



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**Rrenë pas rrenës nga mashtruesit ordinerë:** Kosova është i vetmi vend në Evropë që është nën sanksione ndonëse ndërkombëtarët këto i quajnë masa të përkohshme. Krejt kjo ndodhi shkak i një politike diletante që mendonte se duke e përkrahur Ukrainën, duke ia futur sanksionet Rusisë dhe Putinit, duke u marrë me politikën e jashtme dhe të brendshme të Serbisë, duke e arsyetuar gjenocidin e Izraelit në Gaza në emër të luftimit të Hamasit, duke i lëshuar brekët para Borrellit dhe Lajçakut, duke injoruar luftën e UÇK-së dhe duke u gëzuar që krerët ushtarakë dhe politikë që e fituan pavarësinë, e bënë shtetin, siguruan njohjet, ndërtuan infrastrukturën, po mbahen në burg në Hagë, me një fjalë i mbushën me përmbajtje përpjekjet e Kosovës për shtet do të jenë përcaktuese që bota të aplaudojë dhe të mos bëjë asgjë tjetër veç përkrahjes së këtyre “gjenialëve politikë” ndonëse pjesa dërrmuese e tyre janë analfabetë dhe si infuzion për mbijetesë e kanë injorancën e tyre, angazhimin e Kurtit që është larg tyre me vite të dritës si dhe një opozitë krejtësisht e tredhur. Ndërtuan dhe mbindërtuan tema të mëdha politike dhe kombëtare mbi dhunën që e ushtruan ndaj policisë së Kosovës, por jo edhe asaj ndërkombëtare, mbi dhunën ndaj institucioneve të Kosovës, duke ua vënë flakën dhe duke i sulmuar me granatahedhës, duke dërguar idealistë në vrasje dhe vetëvrasje, duke premtuar bashkim me Shqipërinë në kohën kur të gjitha rrugët çojnë drejt bashkimit me Serbinë, duke premtuar bojkotim të mallrave nga Serbia, ndërsa po ky import tani është më i madh se asnjëherë më parë. Hipokritë, mashtrues, pa moral dhe të poshtër! Alfa dhe omega e aktivitetit të tyre “patriotik” ishin parullat “Jo negociata, vetëvendosje” dhe

kundër “Zajebnicës”. Premtuan çka nuk premtuan, polli miu dhe lindën Vojsa Osmani dhe Glauk Konjufca. Skajshmërisht fleksibilë në qëndrime dhe parime, deri në masë e të qenit pakurrizorë 100 për qind. Kësi raste nuk njeh as anatomia mjekësore. Po a nuk jemi rast sui generis a? U harrua “Jo negociata, vetëvendosje” duke u shndërruar në “Jo vetëvendosje, po negociata”. Zajebnicën nuk e duan sepse i doli boja. por e pranuan bashkësinë e komunave serbe, me autonomi substanciale, arbitrazh ndërkombëtar dhe bashkim të kishës ortodokse me shtetin e Serbisë e jo të Kosovës. U arrit një marrëveshje për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë në Bruksel, me një aneks të Ohrit që Kurti po vdes ta nënshkruajë, por këtë nuk e bën dot Vuçiqi prandaj militantët e LV-së këtë po e shfrytëzojnë si themel mbi të cilat do t’i ndërtojnë mashtrimet dhe rrenat se nuk e pranojnë marrëveshjen pa u nënshkruar nga të dyja palët. Ambasadori i interesave të Serbisë në Kosovë e që është gjerman, i kamufluar si ambasador i Gjermanisë në Kosovë, tha se: “nuk flitet më për nënshkrimin e marrëveshjes, por për zbatimin e saj...”. Gjithashtu, para disa ditëve e lëshoi një rrenë të fortë kur tha se drafti i Bashkësi Zajebnicës është 100 për qind në përputhje me Kushtetutën e Kosovës e që, përveç se nuk është e vërtetë, paraqet ndërhyrje flagrante në pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese duke paragjykuar vendimin e kësaj Gjykate, ende pa shkuar rasti në këtë Gjykatë. Kur dihet se sa llastuce (parimore) janë institucionet e Kosovës ndaj kërkesave të “miqve ndërkombëtarë”, lehtësisht mund të parashihet vendimi i Gjykatës Kushtetuese para presionit të Rohdes dhe ambasadorëve të tjerë!

**Ka filluar zbatimi i marrëveshjes:** Mbi 4000 qytetarë serbë me

shtetësi të dyfishtë, të Serbisë dhe të Zajebnicës në veri të Kosovës u pajisën me tabela RKS e që refuzonin mbi 20 vjet. Se si iu rikthyer dashuria për këto tabela për një kohë aq të shkurtër, për trushpëlarët është lehtësisht e kuptueshme; autoritetet kosovare e kanë shtrirë sovranitetin në veri e që nuk e patën bërë qeveritë e mëparshme lokale dhe qendrore. Për këta që kanë një koçe mend në kokë kjo po bëhet në kuadër të zbatimit të marrëveshjes e jo se qeveria ka shtrirë sovranitet apo se ua ka paguar regjistrimin e veturave me këto tabela. Pastaj, këto tabela do të jenë kompetencë e Zajebnicës në të ardhmen. Nuk është vullneti i Albin Kurtit që ua ka imponuar këto tabela por vendimi dhe loja e Aleksandar Vuçiqit për ta ruajtur epërsinë absolute gjatë bisedimeve me të gjithë kundërshtarët nga Kosova dhe për ta përsheptuar autonominë substanciale që po ua njeh Kurti, pasi Vuçiqi ta nënshkruaj marrëveshjen.

Serbët po pranojnë të dalin në zgjedhje lokale duke e liruar nga “robëria” dhe xhebhanja, Lulëzim Oso Kukën e Leposaviqit dhe Atiqin e Adriana Hoxhiqit, jo se i besojnë KQZ-së por se kështu u ka thënë Vuçkoja dhe Lista e “reformuar” Serbe. Pas këtyre zgjedhjeve serbët do të rikthehen në institucionet e, po mendoni të Kosovës. Jo, në institucionet e Zajebnicës, pa asnjë dyshim. Pasi iu dështoi momentalisht ratifikimi i traktatit për shitje të Burgut të Gjilanit dhe asaj pjesë të sovranitetit të Kosovës një vendi “mik” që do ta shndërrojë Kosovën në fole dhe depo të kriminelëve që Danimarka do t’i heqë qafe për një grusht parash të pista dhe llastucërisë politike kosovare, pa asnjë problem u nënshkrua marrëveshja midis KEDS-it (turk) dhe Elektroserverit (të Serbisë) e që u duartrokkit fuqishëm nga gospodin Rohde,

gospodja von Kramon, gospodin Borrell dhe pan Lajçak. Trutharët dhe druvarët e Albin Babës po e marrin si fillim të faturimit të rrymës në veri të Kosovës dhe kthim të mohuesve të pagimit për rrymën e shpenzuar (qytetarët serbë të Zajebnicës dhe pakicat kombëtare atje në krye shqiptarët) por se nuk iu pengon se faturimin do e bëjë Serbia përmes Elektroserverit, si operator i Zajebnicës që po konkretizohet çdo ditë e më shumë.

Po e shihni që marrëveshja për autonomi substanciale nuk po bëhet pa rezistencën e qeverisë; ata po e njohin këtë autonomi substanciale mirëpo vetëm në mënyrë të sekuencuar duke e ngrënë m...jaltin, jo me kutull por me një lugë çaji.

Dita-ditës do të bëhet më i dukshëm sekuencimi, deri të tregohet i tërë mozaiku, si federatë apo konfederatë e ardhshme e Kosovës me Serbinë. Atëherë, këta që për meny e kanë modelin e sekuencuar, do t’ia mbathin, ku sytë - këmbët. Edhe ashtu shumica Kosovën e kanë si adresë të dytë, adresë e përkohshme. Dikush do të shkojë në gjini, dikush te miqtë, dikush në Serbi nga do të bëjnë luftë për Kosovën dhe qytetarët e saj.

**Po, opozita, a është gjëkund:** Opozita në Kosovë ka mungesë të theksuar potenciale, është e kastruar, e tredhur nga çdo përgjegjësi. Si eunuhë po sillen rreth haremit të Albin Kurtit, me sy lakmojnë, pa koçe dështojnë. Albin Kurti, përmes korrieres Vjosa Osmani ka dërguar një ftesë opozitës për një takim ku do të diskutohej për draftstatutin e autonomisë serbe në Kosovë. Këtë po e thotë publikisht edhe opozita se në Kosovë do të ketë pushtet të tretë dhe autonomi mirëpo, për çudi, duke iu nënshtruar sindromit të Stokholmit, kanë deklaruar se do të shkojnë në këtë takim i cili do

të mbahet kur Vojsa Osmani do ta gjejë një kohë të lirë nga angazhimet e mëdha duke shëtitur botën, pa asnjë rezultat konkret për Kosovën përveç pasurimit të xhirollogarisë dhe duke vizituar valdrinët dhe selmat. Vojsa Osmani nuk arriti ta ndalë as luftën në Ukrainë përkundër faktit se tërë kohën ishte angazhuar për këtë, si presidente fakultative e Kosovës. Bota është dëshpëruar me ne sepse dështuam në Ukrainë ndërkaq po shkëlqejmë në Gazë duke e përkrahur gjenocidin e Izraelit ndaj civilëve palestinezë. Ne e kemi dënuar gjenocidin e Serbisë në Kosovë por po e përkrahim gjenocidin e Natanjahut në Gaza sepse ky qenka gjenocid më i mirë se ai i Kosovës sikur që marrëveshja e Kurtit me Serbinë qenka më e mirë se ajo e Hashim Thaçit dhe Isa Mustafës. Nuk ka më hipokrizi se publikisht të deklarosh se draftstatuti siguron pushtet të tretë, autonomi substanciale për serbët dhe rregullim federativ midis Serbisë dhe Kosovës, gjë që është e vërtetë, dhe, në anën tjetër të shkosh në një takim me një autoparlant kakofonik ku Vojsa Osmani çirret me zërin e Albin Kurtit! Çfarë opozite është kjo, pashë Zotin?! Në këto rrethana opozita do të duhej fuqishëm dhe me të gjitha mjetet ta kundërshtojë pozitën, si në parlament, ashtu edhe me protesta në rrugë. Nuk ka rrugë dhe mundësi tjetër. Demokracia nuk e ka burimin as në Lidhjen Demokratike të Kosovës e as në Partinë Demokratike të Kosovës. Neroni duhet të pengohet ta kallë Kosovën e jo të bëhen përpjekje të lokalizohet zjarri (pasojat) për Kosovën. Po nuk e bëri këtë pozita aktuale, pa asnjë dyshim se do ta bëjë dikush tjetër që do ta trajtojë njëjtë, si pozitën ashtu edhe opozitën. Ndryshe, ikëm për lesh!

**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Envert  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



## Pas kualifikimit në Ligën e Kampionëve, Rrahmani: E arritëm një objektiv

**NAPOLI, 14 DHJETOR** - Kapitëni i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Amir Rrahmani, është i lumtur me kualifikimin e Napolit në të tetën e finales së Ligës së Kampionëve. Kampionët në fuqi të Italisë u kualifikuan tutje, pasi e mposhtën Bragën me rezultat 2-0. "I shënuam dy gola të shpejtë, të cilët na mundësuan të kryenim punë dhe ta kalonim këtë fazë. Sa herë që luajmë me një 11-she të zakonshme, bëhet sigurisht më e lehtë që ta njohim çdo komponentë dhe se duhet të luajmë. Kishte shumë ndeshje në të cilat kemi bërë shumë ndryshime shkaku

i lëndimeve, ndërsa tash, duke luajtur më shumë së bashku, po ia dalim të njihemi më mirë. Braga i pati disa goditje në portë. Është një skuadër që luan futboll të bukur, sikur ne, por fituam duke e bërë një paraqitje të mirë. Ishte mjaft e rëndësishme të fitonim dhe ta gjenim ndjenjën e bukur në shtëpi, për t'ua dhënë edhe tifozëve tanë një gëzim", ka thënë Rrahmani për "Sky Sport". Mbrojtësi "dardan" i qanë humbjet nga Real Madridi, Interi dhe Juventus, derisa e ka lavdëruar trajnerin Walter Mazzarri. "Kishim kundërshtarë të fortë kohën e

fundit, përpos ndërrimit të trajnerit. Por, jemi të lumtur tash dhe duhet ta zbavitim publikun duke luajtur ashtu siç dimë ne. Mazzarri? Është një mastro i taktikës. Është shumë i vëmendshëm për gjithçka që bëjmë dhe edhe për këtë jemi përmirësuar. Disa ndeshje që i kemi humbur na sollën rezultate false, siç ishin takimet me Real Madridin, Interin e Juventusin. Shpresojmë të vazhdojmë kështu. Rruga është e gjatë. Ndërkohë, e kemi arritur një objektiv, që është kalimi i fazës së grupeve të Ligës së Kampionëve", përfundoi Rrahmani.



## MKRS-ja për Evropianin e Xhudos: Të gjithë drejt Pallatit të Rinisë

Prishtinë, 14 dhjetor - Të shtunën në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve në Prishtinë do të zhvillohet për herë të parë Kampionati Evropian i Xhudos ku do të marrin pjesë xhudistët elitare nga gjithë Evropa. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka bërë thirrje për mbështetje sa më të madhe për xhudistët e Kosovës. "Të shtunën të gjitha rrugët çojnë në Pallat të Rinisë dhe Sporteve, ku do të mbahet për herë të parë në Kosovë, Kampionati i Hapur Evropian i



Xhudos!", thuhet në shkrimin e MKRS-së në "Facebook". Xhudistët elitare nga e gjithë Evropa do të garojnë për çmimin e madh prej 300,000 € në total në të gjitha kategoritë. Kampionati i Hapur Evropian i Xhudos, "European Championships Open", organizohet në kuadër të programit shtetëror "Kosova, shtet i xhudos" nga Federata e Xhudos e Kosovës dhe mbështetet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Federata Evropiane e Xhudos.

### SHKURT

#### 'AS': Morena refuzon ofertën e Kosovës

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, kishte një takim me trajnerin Roberto Moreno, që ky ta marrë drejtimin e Përfaqësueses së Kosovës. Mirëpo një gjë e tillë nuk pritet të ndodhë, pasi mediumi spanjoll "AS" raporton se Moreno pritet që shumë shpejt të emërohet trajner i klubit rus, Sochi, duke i lënë kështu anash opsionet që i kishte që të bëhej selektor i Kosovës ose trajner i klubit turk Adana Demirspor. Sochi është në pronësi të Boris Rotenbergut, një nga njerëzit më të pasur dhe më të fuqishëm në Rusi.

#### Jonceviski emërohet trajner i KB Bashkimi

Klubi prizrenas ka njoftuar se trajneri i ri do ta nisë punën nesër (e premte). Ai do të drejtojë për herë të parë Bashkimin të shtunën në ndeshjen e xhiros së 13-të në Superligë ndaj Trepçës në Mitrovicë. "Marrëveshja me trajnerin është arritur tashmë dhe Jonceviski të premten do ta nisë punën me skuadrën. Ka drejtuar skuadra të shumta si Gostivari, Kozhuvri, Trepçën, MZT Skopje. Me MZT-në ka fituar titullin e kampionit dhe Kupën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2016 dhe së fundmi është selektor i përfaqësueses. KB Bashkimi i uron shumë suksese trajnerit të ri Aleksandar Jonceviski", thuhet në njoftimin e klubit prizrenas.

#### KF Drenica ndërpret bashkëpunimin me pesë futbollistë

Skuadra e Drenicës ka njoftuar se ka ndërprerë bashkëpunimin me mirëkuptim me pesë futbollistë që ishin pjesë e skuadrës gjatë sezonit vjeshtor. Fjala është për futbollistët Zenel Gavazaj, Enis Gavazaj, Sunay Hasan, Ardian Hoti, Albin Hasani. Klubi kuqezi i ka falënderuar futbollistët në fjalë për angazhimin dhe kontributin e dhënë për klubin gjatë kohës sa ishin pjesë e kësaj skuadre, duke u uruar suksese në të ardhmen. "Jemi të angazhuar intensivisht për afrimin e lojtarëve të cilat do t'i përforcojnë radhët tona në mënyrë që ta lehtësojmë rrugën drejt objektivit tonë, rikthimit në elitën e futbollit kosovar", thuhet në njoftimin e Drenicës.

## Hamiltoni: Nuk fitohet duke kopjuar të tjerët

Londër, 14 dhjetor - Në vitin 2022, kur në pistë zbritën makinat e reja të Formulës 1, skuadra Red Bulli ishte ajo që kishte projektin më të mirë. Rezultatet e dy viteve të fundit e konfirmojnë këtë gjë, teksa mjaft skuadra e kopjojnë makinën austriake. Nuk është

dakord me këtë ide Lewis Hamiltoni, që i qëndron besnik modelit që Mercedesi ka pasur dy sezonet e fundit. Shtatë herë kampioni i botës sqaron se duke kopjuar Red Bullin nuk mund të fitosh dhe nuk është zgjidhja e duhur për të dalë nga vështirësitë.

“Mjafton të shihni atë që i ndodhi Aston Martin. U përpoqën të kopjojnë Red Bullin dhe në një moment të sezonit makina e tyre nuk arrinte të funksiononte. Duke kopjuar del gjithnjë i dyti”, ka deklaruar Hamiltoni. “Nuk mund të hedhësh poshtë një

projekt dhe të nisësh një tjetër nga fillimi. Duhet të përpiqesh të identifikosh atë që funksionon dhe të vazhdosh në zonat e tjera që kanë probleme. Ne kemi mjaft diferencë me Red Bullin, sidomos në shpejtësinë maksimale dhe kjo është



rruga ku duhet të punojmë”, ka shtuar Hamiltoni.

## Imazhi i ri i ‘Adidas Predator’, Jude Bellingham: Dua të jem Zidane i ri i Realit

MADRID, 14 DHJETOR - Jude Bellingham është tashmë një ikonë e futbollit botëror. Dhe, si i tillë, marka “Adidas” ka zgjedhur atë si imazhin e linjës së saj më përfaqësuese të atleteve të futbollit, “Predator”. Yjet britanikë si Stiven Gerard dhe David Beckham kanë qenë më parë imazh i këtyre atleteve që dje festuan 30- vjetorin e tyre, ndonëse Bellingham nuk ka frikë ta thotë hapur se përfaqësuesi më i mirë i tyre është njeriu i siluetave spektakolare: “Kur shoh këto atlete më vjen në mendje vetëm Zinedine Zidane, një nga mesfushorët më të mirë në histori. Kishte veshur ‘Predatorët’ në finalen ndaj Leverkusenis, me atë gjuajtje volej spektakolare dhe unë shpresoj shumë që të vazhdoj ta ruaj trashëgiminë e tij. Këtë e them jo vetëm pse sot jam këtu si imazh i këtyre atleteve, apo si lojtar i Realit të Madridit, por edhe si trashëgimtar i numrit që ai mbante në fanellë”. Por më shumë sesa legjenda franceze, që me Realin fitoi Ligën e Kampionëve qoftë si



lojtar, ashtu sikurse si trajner (3 radhazi madje), talenti anglez shënon shumë herë më shumë sesa Zidane. “Po, shënoj më shumë se ai, të paktën këtë po e bëj shpesh te Realit, por unë shpresoj që falë edhe frymëzimit të këtyre atleteve, edhe unë të kem momentet e bukura që shijoi Zidane, si personale, ashtu sikurse në klub. Zidane ka qenë një frymëzim për mua dhe padyshim tek ai bazohem për t’u përmirësuar çdo

ditë e më shumë. Ajo që dua të fitoj është vetëbesimi, motivimi dhe të shmangurit presionin në ndeshjen e mëdha, pasi këto cilësi e bënin Zidanen, apo Gerardin dhe Beckhamin, kampionë absolutë. Kështu që unë, nëse dua që ta arrij nivelin e tyre, duhet të vazhdoj të shtyj sa më shumë. Trofeu ‘Golden Boy’ të jetë vetëm i pari personal i shumë të tjerëve që aspiroj”, ka deklaruar ylli i Realit të Madridit, Jude Bellingham.

## Antetokounmpo realizon 64 pikë në fitoren e Bucksit ndaj Indianas

Milwaukee, 14 dhjetor - Milwaukee mposhti me rezultat 140-126 Indianan, duke iu bashkuar Bostonit në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes. Ndeshje e jashtëzakonshme e Antetokounmpos, që realizoi 64 pikë e 14 rebounde, një përbindësh në fushë, i papërmbajtshëm. Ky është rekordi i tij personal, ndërkohë që ndeshja pati disa sherre të vogla si në fushë ashtu dhe pas saj, në dhomat e zhveshjes. Rikthehet te fitorja skuadra e Lakersave, që mundi me rezultat 122-119 San Antonio, në një ndeshje të hapur deri në fund. Davis ishte protagonist, autor i 37 pikëve e 10 reboundeve, ndërsa 30 pikët e Wembanyama për Spursin mbetën për statistikë. Fitore të rëndësishme korri Houstoni, që falë 25 pikëve të Easonit, mundi me shifrat 117-104 rivalët e Memphisit.



Philadelphia qëndron mes ekipeve pretendente në Lindje pas fitores me rezultat 129-111 në fushën e Detroitit. Joel Embiid protagonist, autor i 41 pikëve e 11 reboundeve. Skuadra e Miamit, falë 23 pikëve të Robinsonit, mundi me shifrat 115-104 Charlotten, ndërsa Toronto mundi me shifrat 135-128 Atlantan, ndeshje ku u dallua Siakami me 33 pikë.

### REZULTATET

|                          |         |
|--------------------------|---------|
| Detroit - Philadelphia   | 111-129 |
| Washington - New Orleans | 122-142 |
| Miami - Charlotte        | 115-104 |
| Toronto - Atlanta        | 135-128 |
| Houston - Memphis        | 117-104 |
| Milwaukee - Indiana      | 140-126 |
| San Antonio - Lakers     | 119-122 |
| Phoenix - Brooklyn       | 112-116 |
| Utah Jazz - New York     | 117-113 |

## Katër yje pritët të largohen nga Bayerni

Bayern Munchen është në mesin e skuadrave më të mira në botë, por duket se harmonia brenda grupit nuk është ajo e përkryera dhe kjo gjë pritët të ndryshohet

shumë shpejt. Tekniku Thomas Tuchel dëshiron prej kohësh një “skuadër të re”, nën drejtimin e tij dhe në fund të këtij sezoni mund të bëjë ndryshime rrënjësore te

“bavarezët”. Sipas raportimeve të prestigjiozes gjermane, “Sport Bild”, ish-tekniku i Chelseas dhe Paris Saint-Germainit ka plot katër lojtarë në listën e largimeve

për merkaton e verës, largime, që presin të shkaktojnë jo pak polemika, në radhët e 33 herë kampionëve të Bundesligës. Bëhet fjalë për “fantazistët” e

sulmit, Kingsley Coman e Leroy Sane, kapitenin e mesfushës Joshua Kimmich si dhe “pistonin” kanadez, të krahut të majtë të mbrojtjes, Alphonso Davies.

### SHKURT

#### Presidenti i UEFA-s, bisedë telefonike me Zelenskyn: Mbështetje dhe solidaritet me Ukrainën

UEFA rithekson edhe një herë mbështetjen dhe solidaritetin e saj ndaj Ukrainës. Presidenti i UEFA-s, Aleksander Ceferin, dhe presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, patën një bisedë telefonike së fundmi dhe shprehën pikëpamjet për çështjet aktuale gjeopolitike dhe sportive. Presidenti i UEFA-s shprehu mbështetjen dhe admirimin e tij të palëkundur për Ukrainën dhe guximin e popullit të saj në këto kohë të vështira dhe shprehu shpresën për një zgjidhje të shpejtë dhe paqësore që do të sillte stabilitet dhe prosperitet në Ukrainë. Ceferin, gjithashtu, i uroi kombëtares së Ukrainës fat për ndeshjet e ardhshme të “play-off”-it të “Euro 2024”.

#### Pioli: Tani ta fitojmë Ligën e Evropës

Trajneri Stefano Pioli, pas eliminimit nga Liga e Kampionëve, ka thënë se është koha që të shikohet përpara dhe të triumfojnë në Ligën e Evropës. “Pëngje? Sfidat e parë, ajo kundër Newcastle, duhet ta kishim fituar për atë që dhamë në fushë. Na vjen keq që nuk ia dolëm, kishim shumë pritshmëri në këtë edicion të Ligës së Kampionëve. Tani është koha të shohim përpara. Liga e Evropës është një turne i rëndësishëm. Milani nuk e ka fituar kurrë. Kjo është një mbrëmje e ëmbël dhe e hidhur. E ëmbël pasi Milani nuk fitonte në Angli që nga 2005. Luftuam, besuam dhe fituam, por jemi të zhgënjyer pasi dolëm nga Liga e Kampionëve”, ka thënë Pioli.

#### Xavi: Jam i shqetësuar, por duhet të përmirësohem

Barcelona po kalon nëpër një krizë rezultatesh. Kjo krizë e ka prekur edhe në Ligën e Kampionëve, që pësoi humbje nga Antwerpi (3-2). Trajneri Xavi Hernandez e ka pranuar se është i shqetësuar për skuadrën. “Jam i shqetësuar dhe kjo është normale. Jemi në një moment jo pozitiv. Vijnë nga dy humbje radhazi. Duhet të jemi kritikë ndaj vetes. Duhet të përmirësohem. Të gjithë duhet ta kuptojmë se kjo nuk është ajo çfarë pritet nga Barcelona”, u shpreh Xavi.

#### Osimhen do të bëhet lojtari më i paguar në Serinë A

Victor Osimhen - Napoli pritet ta zgjasin kontratën ndërmjet tyre. Prej kohësh palët janë përfshirë në negociata, që në verë, ku në drejtim të Osimhen erdhën oferta pafund nga klubet më të mëdha evropiane. Presidenti De Laurentis dhe përfaqësuesit e Osimhen kanë gjetur gjuhën e përbashkët për ta rinovuar kontratën. Aktualja përfundon në vitin 2025. Nigeriani do të firmosë një kontratë të re që do të zgjasë deri në vitin 2026, me terma të ndryshuar në shumë aspekte. “Topi i Artë” afrikan do të përfitojë nga kontrata e re 10 milionë euro në sezon, duke u shndërruar në këtë mënyrë në lojtarin më të paguar në Serinë A, aktualisht Osimhen përfiton 4,5 milionë euro. De Laurentis ka arritur të vendosë një klauzolë të re në kontratën me golashënuesin më të mirë të Serisë A, çdo skuadër që dëshiron ta blejë kartonin e tij duhet të paguajë 140 milionë euro.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Omel coffee and cakes” L.L.C. me seli në Gjilan, me pronar Lira Dërmaku, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812021608 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Omel coffee and cakes” L.L.C. Gnjilane, sa vllasnikom Lira Dërmaku, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812021608 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Omel coffee and cakes” L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Lira Dërmaku, has come to the decision to quit its business: 812021608 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Neca Plus” D.O.O. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811504697 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.


**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Neca Plus” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811504697 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability “Neca Plus” D.O.O. has come to the decision to quit its business: 811504697 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Zveçanit**  
Opština Zvečan – Municipality of Zvečan

**Drejtoria e Arsimit**  
Dt.15.12.2023  
Nr. 29/2023

Në bazë të nenit 77 pika 1 e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtaret publikë të Republikës së Kosovës, të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit të punës nr. 03/L-212, nenit 4 dhe 5, të udhëzimit administrativ ne. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Drejtoria e Arsimit shpallë;

**KONKURS**

**Titulli i vendit të punës; Sekretar/e**

- Sekretar/e në SHFMU “Isa Boletini”- Boletin

|                                 |  |
|---------------------------------|--|
| <b>Institucioni;</b>            | Komuna Zvečan                          |
| <b>Departamenti/ Drejtoria;</b> | Drejtoria për Arsim                    |
| <b>Lloji i pozitës;</b>         | Me afat të pacaktuar, me orar të plotë |
| <b>Numri i pozitave;</b>        | Një(1)                                 |
| <b>Titulli i mbikëqyrësit;</b>  | Drejtori i shkollës                    |

**Detyrat dhe përgjegjësitë**

1. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të shkolles dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e tyre.
2. Mban evidencën të kërkesave dhe ankesave të mundshme, mban dosje dhe arkivim të tyre
3. Përditëson dosjet e personelit të shkollës me dokumente dhe të dhëna duke u kujdesur për procedurat ligjore
4. Përgatitë dokumentacionin pedagogjik të shkollës
5. Mer pjesë në grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë;
6. Bë hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga mbikëqyrësi
7. Kryen detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi i tij.

**Kushtet e përgjithshme dhe të veqanta për vendin e punës**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës
- Të ketë zotësi veprimi;
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me ligjin për gjuhët
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formes së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje

**Shkollimi i kërkuar;**

- Përgatitje profesionale adekuate (kualifikimi universitar)

**Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera;**

- Njohuri në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi hulumtuuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel...)


**Dokumentet e nevojshme;**

- Diploma mbi kualifikim universitar
- Diplomat e lëshuara nga Institucionet shkollore jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara (kopje)
- Qertifikata që nuk jeni nën hetime
- Dokument identifikimi(kopje)

**Dokumentet e pranuar nuk i kthehen kandidatëve'**

**Informatë e përgjithshme;**  
Aplikacionet merren dhe dorëzohen pranë zyrës së komuniteteve në fsh. Lipë/ Komuna Zvečan. Afati për aplikim është 15 dite nga data e shpalljes publike të konkursit. Dokumentet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga komisioni.

Drejtoria komunale e arsimit  
Komuna Zvečan





**MITROVICA**  
KOMPANIA UJESJELLESË RAJONALE SH.A.  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.  
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

**D P A**  
Departamenti për punë administrative

Mitrovicë 15.12.2023 / Nr. 1807

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësjetllesë "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, shpallë këtë:

### KONKURS

(Për plotësimin e vendit të punës, punë provuese gjashtë (6) muaj me mundësi vazhdimi)

**I. Pozita e punës:** Drejtor Komercial.

**Kompania:** Kompania Rajonale Ujësjetllesë "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë.  
Paga bazë: 991.25 Euro, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU "Mitrovica".

#### Kushtet për punësim (edukimi i kërkuar):

**Përgatitja profesionale:** Titulli "Master", në drejtimet (Ekonomik, Menaxhment, Administrim Biznesi).  
**Përvoja e punës:** Tri (3) vite përvojë pune, prej tyre së paku dy (2) vite punë menaxheriale.  
**Pozita e hapur:** Një (1) Drejtor Komercial.

#### Kushtet e veçanta:

- ✓ Njohuri të larta të raportimit të performancës dhe proceseve financiare/buxhetore,
- ✓ Të jetë shumë i orientuar drejt qëllimeve dhe zotëroj aftësi të shkëlqyera ndër personale dhe komunikuese,
- ✓ Aftësi të shkëlqyera organizative dhe udhëheqëse,
- ✓ Njohja e punës me kompjuter, programe softuerike (aplikacione) që funksionojnë në kuadër të Ndërmarrjes.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës,
- Drejton, organizon dhe zbaton punët dhe detyrat e caktuara në kompani në Departamentin Komercial si dhe të Marrëdhënies me konsumatorët dhe çështjet specifike (Faturimi, Inspektimi),
- Udhëheq dhe këshillon gjithë personelin vartës për të siguruar rezultate efektive,
- Drejton dhe përgatitë të dhënat komerciale të kompanisë për planin e biznesit,
- Shqyrton dhe aplikon procedurat e aprovuara për sektorin komercial,
- Koordinon, kontakton dhe bashkëpunon në ofrimin e të gjitha të dhënave të aktivitetit të departamentit në varësi,
- Analizon klimën e treguesve dhe tendencat e biznesit në aspektin komercial për të ndihmuar drejtuesit e lartë në krijimin e planeve strategjike për të ardhmen,
- Interpreton informacionin sektorial për të siguruar raportet e nevojshme për vendim-marrje,
- Monitoron procesin e faturimit dhe shitjeve, nivelin e performancës në njësit vartëse, llogaritë e arkëtueshme,
- Sipas autorizimeve të KE-se përfaqëson Ndërmarrjen përpara palëve të interesit,
- Sipas kërkesave përpilon raporte mujore dhe vjetore për ARRU dhe institucione qeveritare,
- Është pjesë ndërlidhëse midis departamentit dhe njësitë e tjera,
- Kryen detyra të tjera, me ZKF-ne koordinon aktivitetet rreth mirëmbajtjes së llogarive të arkëtueshme dhe kryen detyra të caktuara nga Kryeshefi Ekzekutiv, sipas fushës së kompetencës dhe pozitës,
- Për punën që kryen i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

#### Dokumentet e kërkuara:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me këtë aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Letër motivimi,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diploma nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmia nga gjykata kompetente që nuk është nën hetim, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës,
- Një deklaratë nën betim (për pozitën: Drejtor Komercial).
- Kopja e letërnjoftimit.

Aplikacionet mund të merrën ueb-faqën e Kompanisë KRU "Mitrovica" Sh.A. në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/>, si dhe në zyrën për burime njerëzore dhe të dorëzohen në të njëjtën zyrë së bashku me dokumentacionin përcjellës në formë fizike.

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data 15.12.2023 deri me datën 29.12.2023.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Dokumentet e pranuar të aplikantëve në fotokopje nuk kthehen.

Kompania Rajonale Ujësjetllesë "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë inkurajon kandidatet femra, kandidatet nga grupet minoritare si dhe personat me aftësi të kufizuara të aplikojnë.

KRU "Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë



**MITROVICA**  
KOMPANIA UJESJELLESË RAJONALE SH.A.  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.  
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

D A P

Departament za Administrativne Poslove

Mitrovica 15.12.23 Br 1807

Na osnovu Administrativnog uputstva br. 07/2017, Regionalno vodovodno preduzeće "Mitrovica" d.d. u Mitrovici, objavljuje:

### KONKURS

(Za popunjavanje radnih mesta probni rad u trajanju od šest (6) meseci, sa mogućnošću produženja)

**I. Radno mesto: Komercijalni Direktor.**

**Kompanija:** Regionalna Kompanija Vodovod „Mitrovica“ D.D. u Mitrovici.  
Osnovna plata qe biće 991.25 Euro po uredbi o raspodeli prihoda.

#### Uslovi za zapošljavanje (potrebno obrazovanje)

**Stručna sprema:** Maester (Ekonomija, Menadžment, Poslovna Administracija)  
**Radno iskustvo:** 3 godina radnog iskustva, od kojih najmanje 2 godine menadžerski  
**Otvorena pozicija:** Jedan (1) Komercijalni Direktor.  
**posebni uslovi:**

- ✓ Visoko poznavanje izveštavanja performanse i finansijskih/budžetskih procesa,
- ✓ Da bude veoma orijantisan ka cilju i imati odlične međuljudske komunikacijske veštine,
- ✓ Odlične organizacione i rukovodeće sposobnosti,
- ✓ Poznavanje rada sa kompjuterom, softverskim programima (aplikacije) koje funkcionišu u okviru Preduzeća.

#### Radne obaveze i odgovornosti:

- Da bude sposoban/na za obavljanje radnih obaveza sa punim radnim vremenom i bez ograničenja,
- Da usmerava, organizuje i realizuje poslove i zadatke u preduzeću u Sektoru Komercijale, kao i donose sa potrošačima i specifična pitanja (fakturisanje, inspekcija sa potrošačima),
- Da vodi i savetuje svo podređeno osoblje kako bi osigurali efektive rezultate,
- Da upravlja i pripremi komercijalne podatke kompanije za poslovni plan,
- Da pregledai procenjuje odobrene procedure za komercijalni sektor,
- Da koordinira, kontaktira i saraduje u pružanju svih podataka o aktivnostima pdradenog odeljenja,
- Da analizira komercijalnu klimu i poslovne trendove marketinških stručnjaka kao bi pomogli višim rukovodiocima u kreiranju strateških planova za budućnost,
- da tumači sektorske informacije kako bi obezbedio neophodne izveštaje za donošenje odluka,
- Da prati proce fakturisanja i prodaje, nivo učinka u podređenim jedinicama.potraživanjima,
- Da po ovlašćenjima EK zastupa Preduzeće pred zainteresovanim strankama,
- Da prema zahtevima izradi mesečne i godišnje izveštajeza za ARRU i vladinih institucija,
- Da je deo za vezu između odeljenja i drugih jedinica,
- Da izvrši druge zadatke, sa ZKF koordinira aktivnosti oko održavanja potraživanja i da završi određene zadatke od strane glavnog Izvršnog Direktora, prema oblasti nadležnosti i položaja,
- Za poslove koje izvršava odgovara izvršnom Direktor.

#### Traženi dokumenti:

Zainteresovani kandidati moraju da popune prijavu Kompanije i da uz ovu prijavu prilože sledeću dokumentaciju:

- CV (biografija),
- Motivaciono pismo,
- Univerzitetska diploma (overena kopija, dok diplome sa univerziteta u inostranstvu moraju biti overene kod notara),
- Dokaz nadležnog suda koji nije pod istragom, koji važi najviše 6 meseci,
- Dokaz o stručnoj obuci,
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Izjava pod zakletvom (za poziciju: komercijalni direktor).
- Kopija lične karte,

Prijave se primaju na sajtu Preduzeća RVP „Mitrovica“ d.d. na adresi <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/> kao i u kancelariji za ljudske resurse i dostavlja se istoj kancelariji zajedno sa pratećom dokumentacijom.

Konkurs će biti ovoren 15 dana od dana objavljivanja u sredstvima informisanja pocevsi od dana 15.12.2023 do 29.12.2023.

Prijave podnete nakon roka se ne prihvataju, a nepotpune se odbijaju.

Prihvaćena fotokopirana dokumenta podnošocima prijava se ne vraćaju. Regionalno vodovodnopreduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici podstiče kandidatkinje, kandidatke iz manjinskih grupa, kao i osobe sa invaliditetom da se prijave. RVP „Mitrovica“ d.d. Mitrovica





## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

#### 'BAB CLUB' SHPALL TË PAVLEFSHME DY ARKA FISKALE

Biznesi N.Sh.H. "Bab Club" me numër unik identifikues: 811517244 shpall të pavlefshme arkat fiskale me numër: GK52202697 dhe GK52203605.

- Vjollca Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl.I sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë drejtimi Juridik.

- Arbnor Dervishaj shpall të pavlefshme dëftesat Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Naim Hasani shpall të pavlefshme diplomën Q.K."11 Marsi" Prizren.

- Lavdim Ibrahim shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- MD Positive shpall të humbur certifikatën e TVSH-së, me nr. 330453499

- Osman Zeka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Mimoza Bibaj komuna e Malishevës, shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Skyfer Haxhija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.